

Vendim nr. 1 datë 03.01.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Marjana Semini,	Anëtare
Marsida Xhaferllari,	Anëtare

në datën 03.01.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 10 (H) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **HYSNI DIZDARI**, përfaqësuar nga avokat Admir Thanza, me prokurë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-606, datë 01.03.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Dërgimi i çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, 41, 42, 43, 44, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i”, 141 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; nenet 27, 71, pika 1, 71/a, 71/b dhe 76 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 13.06.2006 kërkuesi Hysni Dizdari ka lidhur kontratë kredie bankare me një bankë të nivelit të dytë, në të cilën dorëzanëse është bashkëshortja e tij dhe një shoqëri tregtare në pronësi të kërkuesit me administratore bashkëshorten e tij. Kontrata e kredisë është siguruar me një kontratë hipoteke ku bashkëhipotekues janë të dy bashkëshortët.

2. Kërkuesi nuk i ka shlyer këstet e kredisë në afat, ndaj banka i është drejtuar gjykatës me kërkesë për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit. Me vendimin nr. 768, datë 20.02.2009, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit për kontratën e kredisë bankare dhe Zyra e Përbarimit Kavajë ka filluar procedurën e ekzekutimit të detyrueshëm. Në datën 21.07.2011 bashkëshortja e kërkuesit është paraqitur pranë përbaruesit dhe ka deklaruar ndryshimin e adresës, duke pohuar se po mundoheshin të shlyenin detyrimin ndaj bankës.

3. Pas tre vjetësh nga fillimi i ekzekutimit të detyrueshëm, konkretisht në datën 23.11.2012, kërkuesi ka ngritur padi në gjykatë, me objekt kundërshtimin e veprimeve përbarimore, duke kërkuar shpalljen e pavlefshmërisë së njoftimit të datës 14.11.2012 për zhvillimin e ankandit të dytë në datën 30.11.2012, për pasuritë e paluajtshme të llojit apartament dhe garazh, të ndodhura në Kryemëdhenj, Kavajë, si dhe të të gjitha veprimeve të përbaruesit, përfshirë aktet e ekspertimit.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin nr. 1380, datë 06.11.2013, ka vendosur rrëzimin e padisë. Ndonëse kërkuesi ka paraqitur ankim në gjykatat më të larta, vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr.10-2015-78/35, datë 19.01.2015, ndërsa Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-606, datë 01.03.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit.

5. Në datën 25.10.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit.

II

Pretendimet e kërkuesit

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se Gjykata e Lartë i ka cenuar:

6.1. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, në aspektet e mëposhtme:

6.1.1. *E drejta e aksesit në aspektin substancial*, pasi Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit dhe nuk i ka dhënë përgjigje pretendimit të tij me natyrë kushtetuese. Kërkuesi ka ngritur në recurs pretendimin se gjykatat e faktit, në kundërshtim me ligjin, kanë vlerësuar se padia është paraqitur jashtë afatit ligjor, ndonëse kërkuesi nuk ka marrë asnjë njoftim për procedurën përbarimore. Për rrjedhojë, gjykatat e faktit dhe, në vijim, Gjykata e Lartë, nuk kanë analizuar themelin e mosmarrëveshjes së kërkuesit.

6.1.2. *Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë lidhur me pretendimin kushtetues të kërkuesit për të drejtën e aksesit nuk përmban analizë ligjore dhe i mungon arsyetimi. Gjykata e Lartë shprehet në vendimin e saj se arsyetimi i gjykatës së apelit është i njëjtë me atë të gjykatës së shkallës së parë, ndonëse arsyetimi i tyre është tërësisht i ndryshëm. Arsyetimi i Gjykatës së Lartë është standard, duke mos i dhënë asnjë përgjigje kërkuesit.

6.2. *Të drejtën e pronës*, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, si rezultat i cenimit të procesit të rregullt ligjor në drejtim të aksesit në gjykatë.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në vështrim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi

ka qenë palë në procesin gjyqësor objekt ankimi, për rrjedhojë justifikon interesin në çështjen e parashtruar.

9. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm. Për pasojë, ai nuk ka mjete të tjera juridike në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

10. Për sa i takon kriterit *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000, parashikon se afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në rastet e kundërshtimit të vendimit gjyqësor të Gjykatës së Lartë, Gjykata e ka llogaritur afatin ligjor 4-mujor, duke filluar nga data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në rastin konkret, Kolegji vëren se procesi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesi ka përfunduar me vendimin e datës 01.03.2023 të Gjykatës së Lartë, i cili është publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 07.10.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 25.10.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

12. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar se i janë cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor (në aspektet e së drejtës së aksesit dhe standardit të arsytimit të vendimit), si dhe e drejta e pronës private, të garantuara nga nenet 42 dhe 41 të Kushtetutës. Këto të drejta *prima facie* hyjnë në juridiksionin e Gjykatës, ndaj Kolegji do t'i analizojë në vijim.

13. Lidhur me të drejtën për një proces të rregullt ligjor, kërkuesi ka pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit i ka cenuar aksesin substancial në gjykatë dhe standardin kushtetues të arsytimit të vendimit. Ai ka parashtruar se Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje pretendimit të tij se gjykatat e faktit, në kundërshtim me ligjin, kanë nxjerrë përfundimin se padia ishte paraqitur jashtë afatit ligjor, duke mos konsideruar faktin se kërkuesi nuk kishte marrë njoftim për procedurën përmbaremore. Po kështu, sipas kërkuesit, vendimit të Gjykatës së Lartë i mungon analiza ligjore, si dhe përmban pasaktësi kur shprehet se arsytimet e vendimeve të gjykatave të faktit janë të njëjta.

14. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se nëse mohohet e drejta e aksesit, procesi konsiderohet i parregullt, sepse ajo, përpara së gjithash, është kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Në këtë kuptim, e drejta për të pasur akses në gjykatë i garanton individit të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura (*shih vendimet nr. 16, datë 23.03.2023; nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, e drejta e aksesit mund të kufizohet kur bëhet fjalë për kushtet e pranueshmërisë së një ankimi, siç janë afatet e përcaktuara në Kushtetutë dhe ligje, të cilat janë në funksion të parimit të sigurisë juridike (*shih vendimet nr. 9, datë 07.02.2017; nr. 18, datë 31.03.2014; nr. 17, datë 19.06.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. E drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje (*shih vendimet nr. 79, datë 14.12.2017; nr. 63, datë 23.09.2015; nr. 3, datë 26.01.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Lidhur me vendimet e mospranimit të rekursit të Gjykatës së Lartë, jurisprudenca kushtetuese ka vlerësuar se arsyetimi i kufizuar i tyre nuk cenon të drejtën për proces të rregullt ligjor. Kjo formë arsyetimi shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit. Arsyetimi i kufizuar i dhënë nga Gjykata e Lartë në formulimin e vendimit në dhomën e këshillimit është tregues i faktit që kërkuesi nuk ka ngritur një nga argumentet ligjore të përcaktuara në dispozitën përkatëse të legjislacionit të brendshëm, që është kusht për pranimin e kërkesës (*shih vendimet nr. 49, datë 10.07.2015; nr. 8, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Zbatimi i standardit kushtetues të arsyetimit të vendimit vlerësohet rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes dhe natyrës së vendimit, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e tyre (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 79, datë 14.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në rastin konkret, Kolegji vëren se gjykata e shkallës së parë i ka analizuar pretendimet e palëve ndërgjyqëse dhe ka arritur në përfundimin se kërkuesi, në cilësinë e paditësit në atë proces, ka marrë dijeni rregullisht për çdo veprim të përmbaruesit gjyqësor, qoftë vetë ose nëpërmjet bashkëshortes së tij, e cila është njëkohësisht edhe bashkëhipotekuese edhe dorëzanëse me kërkuesin (*shih faqen 8 të vendimit të gjykatës së shkallës së parë*). Në vijim, ajo gjykatë ka

shqyrtuar edhe pretendimet lidhur me vlerën e sendit të sekuestruar, duke iu referuar fakteve të përcaktuara nga provat dhe ligjit të zbatueshëm për vlerësimin me ekspert. Mbi bazën e kësaj analize, gjykata e shkallës së parë ka arritur në përfundimin se padia e kërkuarit duhej rrëzuar. Ndërsa gjykata e apelit ka shqyrtuar të gjitha veprimet e përmbartuesit gjyqësor dhe ka arritur në përfundimin se rregullat e njoftimit gjatë procedurës përmbartimore ishin në përputhje me dispozitat ligjore të Kodit të Procedurës Civile (KPC), duke evidentuar se kërkuari kishte marrë dijeni rregullisht për to. Për këtë arsye, gjykata e apelit ka nxjerrë përfundimin se padia e ngritur nga kërkuari në datën 23.11.2012 ishte jashtë afatit ligjor 5-ditor për kundërshtimin gjyqësor të veprimeve përmbartimore dhe ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë (*shih faqet 6-7 të vendimit të gjykatës së apelit*).

18. Për sa i takon vendimit të Gjykatës së Lartë, që kundërshtohet nga kërkuari në ankimin kushtetues individual, Kolegji vëren se aty janë parashtruar pretendimet e ngritura në rekurs nga kërkuari, si dhe vlerësimi se gjykata e apelit i ka respektuar të gjitha parimet bazë të zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor, ndërsa ka vlerësuar se pretendimet e tjera të kërkuarit lidheshin me çështje të vlerësimit të provave, çka del jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të saj (*shih paragrafët 18-19 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Me këtë arsyetim, Gjykata e Lartë ka arritur në përfundimin se rekursi nuk përmbante shkaqe të parashikuara nga neni 472 i KPC-së (*shih paragrafin 20 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

19. Për sa më lart, Kolegji, duke iu referuar arsyetimit të gjykatave të zakonshme, konstaton se kërkuari e ka ushtruar të drejtën e tij të paraqitjes së kërkesëpadisë, ku përmes një procesi gjyqësor, në të cilin janë përcaktuar faktet dhe është zbatuar ligji, është arritur në përfundimin se padia e tij ishte paraqitur jashtë afatit ligjor. Në këto rrethana, pretendimi i tij se i është cenuar e drejta e aksesit është haptazi i pabazuar, për sa kohë ligji procedural, bazuar në parimin e sigurisë juridike, ka përcaktuar afate brenda së cilës mund të paraqitet padia në gjykatë, afate të cilat nuk janë respektuar nga vetë kërkuari. Për këtë arsye, edhe vendimi i Gjykatës së Lartë, i marrë në dhomën e këshillimit, në funksion të shqyrtimit paraprak të rekursit, nuk cenon të drejtën e aksesit, ndaj pretendimi i kërkuarit në këtë drejtim është haptazi i pabazuar.

20. Kolegji, gjithashtu, konstaton se, në ndryshim nga sa pretendon kërkuari, Gjykata e Lartë i ka dhënë përgjigje pretendimit të tij se gjykatat e faktit kanë nxjerrë një përfundim në kundërshtim me ligjin kur deklarojnë se padia është paraqitur jashtë afatit ligjor, pasi ajo gjykatë ka vlerësuar se gjykata e apelit ka respektuar normat procedurale, të cilat mund të çojnë në

pavlefshmërinë e vendimit gjyqësor ose të procedurës së gjykimit, si dhe nuk ka pasur shkaqe të rënda procedurale që të kenë ndikuar në dhënien e vendimit (*shih paragrafin 18 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Po kështu, lidhur me pretendimin e kërkuarit të vendimit të Gjykatës së Lartë i mungon analiza ligjore, si dhe përmban pasaktësi, Kolegji çmon, se arsyetimi i kufizuar i vendimit të mospranimin të rekursit nuk ka cenuar standardin kushtetues të arsyetimit, në kushtet kur Gjykata e Lartë në vendimin e saj ka parashtruar shkaqet e rekursit. Për sa i takon argumentin të kërkuarit për pasaktësi në paraqitjen e arsyetimit të vendimeve të gjykatave të faktit, Kolegji vëren se në pjesën hyrëse të vendimit të Gjykatës së Lartë është parashtruar se ato gjykata kanë pasur të njëjtin arsyetim, duke nënkuptuar rrethanën ligjore të njoftimit të rregullt të kërkuarit për veprimet përmbartimore, që sipas ligjit pasjell rrezimin e padisë për shkak të mosrespektimit të afatit. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se edhe ky argument i kërkuarit nuk mjafton për të vënë në dyshim respektimin e standardit kushtetues të arsyetimit të vendimit të Gjykatës së Lartë, ndaj pretendimi për cenimin e këtij standardi, është haptazi i pabazuar.

21. Në lidhje me të drejtën e pronës private, kërkuari ka parashtruar se ajo i është cenuar për shkak se procesi gjyqësor i zhvilluar ka cenuar të drejtën e aksesit në gjykatë. Kolegji, duke vlerësuar se pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit është haptazi i pabazuar, sipas arsyetimit të mësipërm, arrin në përfundimin se edhe pretendimi për cenimin e së drejtës së pronës është haptazi i pabazuar dhe, si i tillë, nuk mund të merret në shqyrtim.

22. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.